



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izleazna

Nr. 1-07
Br. _____

Data 19.01.2023
Datum _____

OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.12.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkrjetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkrjetar i Komunës për komunitete, drejtorët komunal, përf. e KFOR-it,

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal
4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit nr.-II-1721, i dt.09.12.2022, për miratim paraprak të Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2023
5. Diskutimi i Raportit të Performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2021
6. Dhënia e pëlqimit për diskutim publik të Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesës nr.-III-392, të dt.16.12.2022, për aprovimin e Planit Komunal të Integritetit për vitin 2023-2026
8. Shqyrtimi i raportit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale sipas rekomandimeve të Ministrisë së linjave
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 19 vota.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Valbonë Beka me arsye

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesja – Sqaron se në procesverbalin e mbledhjes së kaluar ka ndodhë një gabim teknik ku në faqen nr.5 të procesverbalit në vend të emrit Sami Ahmeti duhet të jetë emri Hamit Mjeku. Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 12 vota për dhe 6 vota abstenim me sqarimin e cekur më lartë.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

Ibush Mjekiqi – Duhet të merret viza këtu, me arsyen se është e rregulluar me ligj, do të thotë se Komuna pa e marrë vizën dhe pa e nënshkruar bashkëpunimin në mes të Komunave, nuk mundet të kaloj. Është e vërtetë se Asociacioni i Komunave i kordinon, por është çështje teknike administrative që marrëveshja duhet të bëhet në mes të Komunave në fushat e caktuara.

Enver Gashi – Ne jemi për aprovimin e këtij propozim vendimi.

Sami Ahmeti – Duke qenë se është seanca e fundit e Kuvendit komunal për këtë vit. shfrytëzoj rastin të ju uroj juve, të gjithë të pranishmëve si dhe qytetarëve të Obiliqit vitin e ri, duke iu dëshiruar të gjitha të mirat për vitin e ardhshëm. Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, kjo nismë që ka kërkuar Kryetari për të rivendosur bashkëpunim ndërkomunal po duket se është bashkëpunim mbi bashkëpunim. E thashë e rivendosur pasi që kemi Asociacionin e Komunave, që është tashmë bashkëpunim e që në misionin e tij është të krijoj qeverisje lokale, efikase, të qëndrueshme dhe demokratike përmes projekteve të përbashkëta me Komunitat dhe përmes tyre të arrihet një performancë dhe kualiteti i lartë në shërbimin e nevojave për banorët e Komunave edhe në fushat që ju i keni cekur në këtë propozim për bashkëpunim. Mua, më intereson të dijë psh:

- Te fusha e mirëqenies sociale, që është radhitur si fusha e parë e bashkëpunimit potencial çka përfshin kjo fushë, a përfshin sjelljen e organizuar të më shumë banorëve nga komunitetet që kanë këto Komuna, siç ka ndodhur deri më tani.
- A e dini se Komuna e Obiliqit, është bërë oazë e banorëve me kushte të rënda ekonomike që po vijnë nga Komunitat tjera dhe pse po ndodhë kjo.
- A e dini se Komuna e Obiliqit, ka shumë nëna vetëushqyese të koncentruara në Obiliq, pra të ardhura nga Komunitat tjera, pse po ndodhë kjo dhe pse kemi nevojë ne që me buxhetin e banorëve të kontribuojmë mirëqenies sociale të banorëve të Komunave tjera.

Vetëm për këto çështje, kisha pasë dëshirë të marrë përgjegje, në të kundërtën ne jemi pro bashkëpunimit nëse, ai nuk shkon në dëm të qytetarëve tonë kryesisht në pikat të cilat i ceka.

Ajet Berisha – Është një zhvendosje e bashkëpunimit se në mandatin e kaluar Kryetari ka pasë bashkëpunim me Komunitat Drenas, Skënderaj, Vushtrri dhe Mitrovicë, do të thotë jug-perëndimore, e tash ktheje nga jug-lindore. Mirëpo, qëllimi i tyre absolut i bjen në letër krejtë pa asnjë kërkesë të saktë, kemi me bashkëpunue në sektorët që i ka Komuna jonë dhe Komunitat tjera, jo në sport, jo në mirëqenie, jo në këtë. Është krejtë letër e panevojshme sepse nuk është ofruar asnjë element që është me rëndësi, që tregon se ky bashkëpunim është në interes të qytetarëve të Obiliqit dhe cilësdo Komunitat tjetër, apo kërtyre Komunave të përmendura. Edhe sot nëse, votojmë ne për këtë bashkëpunim që është krejtë formal, që absolut kurgjë nuk paraqet, çfarëdo marrëveshje që nënkupton shpenzim të buxhetit të Komunës në bashkëpunim me një Komunitat tjetër prapë ka me ardhë këtu, me u votue në Kuvend sepse e përcakton LVL-ja. Çdo iniciativë që merrë Kryetari i Komunës me cilindo Kryetar të Komunës tjetër për një investim të përbashkët, për një diçka që i përket 2 Komunave, ajo marrëveshje duhet me ardhë prapë me u votue këtu. Prandaj, kjo është

krejtë e panevojshme, nuk po e di edhe qëllimi për çka ka ardhë kjo letër se përveç shpjegimeve të munguara nga ana juaj, edhe aspektin ligjor nuk po e kuptoj pse ka ardhë sepse nuk sjellë kurrfarë benefiti, as për këto Komuna të përmendura kjo letër. Çdo marrëveshje tjetër prapë duhet me ardhë këtu, me u votue prej Kuvendit sepse është e pamundur me u realizue çdo gjë në mes të 2 Komunave, apo edhe më shumë pa u votue në Kuvend. Pra, nuk ke nevojë me mbivotue nga 2 e 3 herë për çdo marrëveshje që mund e bën. Andaj, për mua është e kotë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 5 vota kundër morën Vendim për aprovimin e Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

Pas votimit, anëtarët e Kuvendit komunal znj. Samir Berisha dhe Linda Sadiku Krasniqi, e lëshuan mbledhjen pa asnjë shpejgim.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet Shqyrtimin e Propozim Vendimit nr.-II-1721, i dt.09.12.2022, për miratim paraprak të Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2023. Ishte edhe një rekomandim ku është shtue edhe një parcelë në mbledhjen e KPF-së, që besoj se e keni pranue.

Enver Gashi – Ne nuk kemi me shtue kurgjë, por ky është obligim vjetor të gjitha parcelat që janë të lira duhet të shpallen si të lira dhe ne jemi për.

Sami Ahmeti – Ne e dijmë që proceduralisht nëse, parashihen të jepen në shfrytëzim pronat e caktuara për vitin vijues ato duhet të miratohen nga Kuvendi komunal në vitin paraprak. Kjo, do të ishte normale sikur të kishim një sukses të theksuar nga pronat e dhëna paraprakisht kryesisht në ngritjen e punësimit dhe mirëqenies së qytetarëve të Obiliqit. Kjo nuk ka ndodhur deri më tani kur dihet se pronat e dhëna, apo edhe të marrura për vete nga ky Kuvend, janë keqpërdorë, nuk janë kryer investimet e parapara dhe këtë e ka konfirmuar edhe Komisioni juaj, raportin e të cilit na e keni sjellur në njërin nga mbledhjet e Kuvendit komunal. Ajo që jemi kundër është edhe fraza që është cekur në këtë propozim vendim, e që është dhënia në shfrytëzim afatgjatë e këtyre pronave, kur dihet se ligji lejon dhënien e tyre edhe në afat më të shkurtër, në mënyrë që të shihet nëse investitorët po e respektojnë kontratën dhe po e zbatojnë planin e investimeve. Pastaj, si parashihen ato të jepen në shfrytëzim kur dihet se ne ende nuk kemi plan zhvillimor të miratuar që do të orientonte zhvillimin e investimeve në fushat e caktuara. Duke u nisur nga përvoja e shumicës së pronave, që i kemi dhënë deri më tani në shfrytëzim, ne kemi dyshime të theksuara për keqpërdorime, apo thënë më thjeshtë shumica e pronave komunale nuk janë dhënë në shfrytëzim, ato janë shitur dhe kësaj pune së shpejti do të ia ndjeni erën. Natyrisht që jemi kundër këtij propozimvendimi.

Ajet Berisha - Unë jam kundër sepse nuk janë duke u respektue procedurat, që është plani zhvillimor komunal. Do të thotë, se në rast se Komuna e Obiliqit nuk e ka të miratuar një plan të tillë krejtë kjo, edhe është në kundërshtim me ligjet sepse kjo është dashtë të parashihet fillimisht në planin zhvillimor që me iu dhënë mundësia për me ofrue këtë listë, që Komuna në vitin 2023 me pasë mundësi. Kjo, është në kundërshtim me ato qysh i parashehë ligji. Andaj, për mos me i përsëritë ato që i tha parafolësi mjafton kjo pikë që kjo është e kundërligjshme.

Enver Gashi – Sa janë të kundërligjshme dhe sa janë të suksesshme dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave shihet se ne çdo vendim që këtu e marrim pa aprovimin e MAPL-së, nuk e konsiderojmë se është në rregullë. Nëse, ju nuk e njihni MAPL-në, si Ministri atëherë gjithçka është ok, gjeni një tjetër fantamë të juaj që është tjetër gjë. Nëse, doni me pa se sa ka zhvillim këto prona që janë dhënë deri më sot shkoni në parkun e biznesit, shikone sa punimet janë duke u zhvilluar, që disa veç kanë fillue, e disa janë në fazën e ndërtimit. Edhe është obligim ligjor, nuk e kemi shpikë ne këtë dhe a kemi plan zhvillimor aty, sigurisht se Ministria e din dhe të mos bëhemi ne më pop se papa. Thjeshtë, jeni veç duke marrë kohë të them se kam ardhë këtu, dhe duhet me folë diçka.

Sami Ahmeti – Unë nuk e di se çka deshti me thënë parafolësi sepse nganjëherë përpara kanë thënë pleqve dëgjoja fjalët, e mos i dëgjo diçka tjetër. Mirëpo, tash as fjalët nuk ka mbetë me ia dëgjue njerëzve të tillë se nuk ka të bëjë kjo me çështjen ligjore pranimin, ose jo të Ministrive sepse ne po e dijmë se letrat po bëhen

në formë të rregulltë. Sa i përket miratimeve, po merret miratimi prej Kuvendit, por pas kësaj këto po keqpërdoren. Ne e kemi një raport që ju na e keni sjellë në qershor, apo në korrik ku shumica e këtyre pronave, nuk i kanë plotësue kushtet, raporti që ju vetë e keni sjellë, Komisioni i juaj. Unë kurgjë më tepër nuk thashë dhe ju thashë raporti që Komisioni juaj e ka sjellë pronat e dhëna deri më tash, shumica e tyre janë keqpërdorë, nuk i kanë zhvillue aktivitetet për të cilat e kanë marrë atë pronë. Kjo, ishte ndërsa sa i përket fjalëve tjera, nuk i marrë shumë seriozisht sepse nuk ka rëndësi.

Enver Gashi – Së pari kryesuese, një vërejtje edhe pse je në grupin tonë, nuk iu përmend emri parafolësit mos ia jepë fjalën veç që i teket, ose një konsideratë sepse konsiderata është e tepërt, është e dëmshme. Nuk ka nevojë me marrë fjalën kur unë nuk ia përmendi emrin. Unë nuk fola pas fjalimit të tij dhe nuk merrem me të.

Sami Ahmeti – Pikërisht pas fjalimit tim fole.

Enver Gashi – Këtu, është një rend, është Kuvend dhe nuk është kush çka të don, kujt çka i teket.

Ajet Berisha - Jo, veç z.Enver me i thënë se s'po më intereson çka tha për pjesën e asaj çka tha sikur atij s'po i intereson çka po shkruan në letër. Ligji për dhënien e pronës në shfrytëzim, thotë prona e cila paraqitet në këtë listë duhet të jetë e paraparë në planin zhvillimor komunal. Ne nuk e kemi një plan të tillë dhe është në shqyrtim e sipër. Meqë, kjo nuk është unë ia kujtoj z.Enver, le te lexon ligjin para se me i thënë disa fjalë, jo është, jo nuk është. Edhe për Ministrinë tona, unë pikërisht për çështjen e njejtë 2 kërkesa dhe 2 shkresa ia kam dërguar Ministrisë në vitin e kaluar, fatkeqësisht as përgjegjë nuk më është. Herën e parë është përgjegjë vetëm për ato që ka pasë argument, herën e dytë hiç nuk më është përgjegjë. Kjo, do të thotë se aftësia e këtyre Ministrive tona, për me i tejkalue kundërligjshëm disa dokumente është e njohur prandaj z.Enver, nuk kemi nevojë me pasë telall, shpjegim, ose rishpjegim për diçka çka shkruan qartë. Për me u paraqitë këto lista duhet me qenë në planin zhvillimor dhe Komuna e Obiliqit nuk ka plan zhvillimor sepse është në shqyrtim e sipër. Pra, duhet të jenë aty të parapara dhe në rast se nuk janë ti nuk mundesh me i paraqitë hiç.

Kryesuesja – Z.Gashi, mirë e potencoi se nuk e përmendi emrin tuaj.

Ibush Mjekiqi – Ne jemi duke biseduar për një çështje ligjore, që është edhe obligim ligjor me i paraqitë këto prona me i bë publike dhe se a do ti japim në shfrytëzim apo jo, varet prej procedurave të mëtutjeshme, të cilat do të ndjeken në vitin e ardhshëm. Mirëpo, obligim ligjor është me qenë të publikuara pronat e paluajtshme publike që i kemi. Në planin zhvillimor natyrisht e dini se jemi duke punuar që 4,5 vite, drejtori e ka udhëheqë atë proces dhe plani zhvillimor shumë shpejtë do të aprovohet në këtë Kuvend. Ne jemi në fazën finale dhe sigurisht se atje janë të paraqitura, por sido që të jetë për çdo vit kjo bëhet, është fundi i vitit, seanca e fundit, që për vitin e ardhshëm duhet të publikohen. Është një çështje tepër administrative, obligim ligjor dhe mua po më befason fjalori si dhe konstatimet e dhëna se janë keqpërdorë, apo nuk janë keqpërdorë. Unë absolutisht jam kundër keqpërdorimit, por sinqerisht duhet me pasë fakte dhe nëse, flasim për keqpërdorim atëherë duhet me emër e mbiemër sepse çdo gjë ka adresë.

Arben Berisha – Pasi që përmes Drejtorisë tonë ka ardhë kërkesa e Kryetarit, nuk kisha me hy në detale sepse nuk është normale nëse, unë them se Ministria i ka njerëzit e papërgjegjshëm. Më vjen keq, nëse këto fjalë dalin nga një anëtar i Kuvendit tonë sepse një përgjegjë që nuk ta ka kthye dhe thua se Ministria, është e papërgjegjshme.

Ajet Berisha – Më vjen keq, por është obligim ligjor me kthye përgjegjë

Arben Berisha – Keqardhjen tënde dhe timen e ka tregue vota e popullit, por ta ka dhënë vetëm 5 %, 64 % ne i kemi fitue. Mirëpo, ne e falenderojmë dhe jemi me respekt ndaj Ministrisë, ndaj ministrit që ka bërë punë të madhe dhe pse ty z.Ajet, nuk ta paska kthye një shkresë qenka bërë shumë punë e madhe.

Ajet Berisha – Më vjen keq, qifti yt me na mbajtë ligjëratë këtu, është vdekje.

Arben Berisha – Unë të mbaj ligjëratë se kam emër dhe jam për këtë me të mbajtë ligjëratë. Ty të ka mund edhe lista sërbe, atë bashkimin tënd kombëtar ta ka mund edhe lista sërbe.

Kryesuesja – Ju lutem, keni kujdes fjalorin që po e përdorni dhe z.Berisha, e keni kaluar kohën e minotazhës, nuk keni të drejtë me folë.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, e ndërprejmë seancën dhe vazhdojmë pas 10' pushim.

Kryesuesja – Pas 10' pushim 18 anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm dhe vazhdojmë me mbledhjen.

Arben Berisha – Ne e kemi praktikë se edhe në vitet e kaluara e kemi shpallë dhënien në shfrytëzim, kështu që vetëm po e sqarojmë se Ekzekutivi nuk i jepë pronat në shfrytëzim, por Kuvendi dhe ne vetëm e monitorojmë. Fatbardhësisht ne ishim në një seminar dhe 33 vjetorin e LDK-së, atje e kemi mbajtur. Unë e ndjej veten mirë dhe ju duhet ta ndjeni mirë se ajo zonë është shumë zonë potenciale e Obiliqit. Sa i përket keqërdorimit kush çka ka janë instancat e shtetit ku mund të shqyrtohen. Ne edhe në këto kushte kemi një plan zhvillimor dhe kjo për ty nuk është e pranueshme, por nëse nuk aprovohet ky plani ynë, ne e kemi planin aktual që me planin aktual është zonë zhvillimore, është zonë ekonomike. Mbi të gjitha pas 3 vjete, prapë popullit ka me folë dhe aty prej 64 %, 80 %, z.Ajet, ne mendojmë me dalë ndërsa kush është hajn, e kush nuk është ti trego pse Kryetari të ka dërgue në shtëpi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 5 vota kundër e aprovuan Propozim Vendimin nr.-II-1721, të dt.09.12.2022, për miratim paraprak të Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2023.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Kërkon nga kordinatori i performancës që në pika të shkurta të sqaron raportin e performancës të Komunës së Obiliqit, për vitin 2021.

Berat Mehmeti – Matja e performancës bëhet me qëllim që të siguroj një monitorim të ofrimit të shërbimeve nëpërmjet matjeve të vlefshme të performancës, të ofroj informata të nevojshme për lehtësimin e vendimmarrjes në Komunë dhe të motivoj organet e pushtetit lokal për promovim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies gjatë punës së tyre në krijimin e kushteve sa më të dinjitetshme për të gjithë qytetarët e Komunës. Si proces ka filluar në vitin 2009, ndërsa në këtë vit është përpiluar edhe dokumenti kryesor në bazë të cilit sqarohet saktë se çka raportohet dhe si janë formulat e matjes. Sistemi i menaxhimit të performancës në Komuna përbëhet nga 19 fusha, gjithsejt 119 tregues Në grandin e performancës prej 119 treguesve vlerësohen vetëm 30 tregues, do të thotë se grandin e performancës dhe performanca e Komunës janë 2 gjëra të ndryshme të cilat vlerësohen nga Komisione të ndryshme në kuadër të MAPL-së. Në vitin 2021, Komuna e Obiliqit nga gjithsejt 100 %, ka arritur 71.38 % të performancës, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ka qenë 68.68 %, por për shkak të pandemisë janë vlerësuar vetëm 102 tregues nga gjithsejt 119. Dallimi prej vitit 2019 dhe 2020 është se në vitin 2020 ka filluar matja e performancës përmes sistemit elektronik, do të thotë në mënyrë digjitale është krijuar sistemi i cili shumë shpejtë do të jetë publik edhe për qytetarët e interesuar. Gjatë vitit 2021 vlen të theksohet se në nivel vendi performanca e të gjitha Komunave, ka qenë 56.80 % mesatarja ndërsa, ne e kemi 78.38 % dhe sipas llogaritjeve supozohet se jemi në vendin e 4 të performancës në nivel të vendit. Vlerësimi i grandit të performancës si proces ka përfunduar në muajin nëntor 2022, pastaj ne e kemi kaluar edhe verifikimin në terren ka qenë një Komision i MAPL-së, ku ne kemi punuar 2 ditë me radhë në verifikimin e treguesve në terren. Tani, jemi në pritje të shpalljes të rezultateve finale, të cilat ligjërisht është dashur të shpallen para një muaji. Mirëpo, Ministria është duke e bërë një vonesë të paarsyeshme për publikimin e këtyre rezultateve. Siç e dini edhe ju grandin e performancës është një grand i donatorëve të ndryshëm, ku është e përfshirë edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, që në këtë vit është 8 milionë euro, vlera dhe janë kualifikuar vetëm 6 Komuna dhe njëra prej tyre jemi ne.

Ajet Berisha – Ishte një shpjegim i shpejtë dhe korrekt prej anës së juaj. Unë jam i interesuar për qindjet që i keni paraqitur këtu, si realizime me këta indikatorë që janë marrë a është e vërtetë, apo unë kam dyshime. Për shembull ka shumë qind për qindje që i keni dhënë këtu, që unë jam i sigurtë se nuk është ashtu. Objektet e reja me leje ndërtimi qind për qind dhe ju mundeni me thënë se qind për qind i llogaritni atyre që iu keni dhënë leje, por jam i bindur se krejtë me leje nuk janë në Komunën e Obiliqit.

Berat Mehmeti – Ne kur raportojmë raportojmë me kërkesat që po thotë drejtori dhe sa kërkesa janë aprovuar.

Ajet Berisha – Veç qind për qind nuk është nëse, tjetri nuk ka kërkuar leje hiç por ka ndërtue, a jemi ne të obligueshëm për atë punë sepse nuk duhet me lënë me ndërtue pa leje. Indikatorit thotë qind për qind, por nuk e ke qind për qind që kanë kërkuar leje. E dyta, dua shpjegime të tilla që me ditë pse ka ardhë qind për qindshi. Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht qind për qind, që s'ka mundësi hiç sepse ne nuk i mirëmbajmë të gjitha hapësirat publike qind për qind. Ti mund të thuash ndoshta, 1 herë në vit, ose 1 herë në 5 vite trajtohet ndonjë hapësirë, por rregullisht tash çka nënkuptojmë me këtë. Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik qind për qind, nuk është e vërtetë, ose rrugë lokale të shtruara qind për qind, që prapë kjo nuk është e vërtetë. Edhe ju e dini që nuk është e vërtetë, ose çka nënkupton tjetër qind për qind, do të thotë janë shumë indikatorë këtu që e kanë qind për qindëshin dhe që praktikisht ne e dijme se nuk është e vërtetë. Mua, më intereson pse ka ardhë deri te qind për qindshi, qysh është ardhë matja kur e dijme se kjo nuk është e vërtetë, as nuk janë të mirëmbajtura qind për qind, as nuk janë të ndriçuara qind për qind, as nuk janë rrugët lokale të shtruara qind për qind. Do të thotë, këto i dijme saktë pse o ardhë deri te qind për qindshi.

Berat Mehmeti – Përgjegjjet sa i përket lejeve ndërtimore ne kur raportojmë, raportojmë me dokumente që i ka Drejtoria e kadastrit, do të thotë kërkesat që janë bërë dhe sa janë aprovue prej tyre. Ndërsa, çka bëhet në terren unë nuk jam kompetentë të përgjegjem për atë çështje sepse nuk e di. Unë kam raportuar në bazë të dokumenteve që i ka Drejtoria përkatëse dhe kjo është gjendja reale. Këto, filtrohen edhe në Ministrii, ata përsëri kërkojnë dokumente sepse ka tregues që ndoshta, është dashtë me u ngarku 110 dokumente dhe ne vetëm dërgojmë dokumente. Sa i përket mirëmbajtjes nuk hyn krejtë territori i Komunës, por hyn vetëm parku, sheshi, oborri i shkollës, këto që ne i kemi obligim me i mirëmbajtë. Kjo, vlen edhe për ndriçim publik dhe fjala është për këto hapësira publike, e jo për krejtë territorin.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se secili prej neve e dijme se qind për qind rrugët e lagjeve nuk përfshihen, por po flasim për rrugën kryesore që nuk ka lokalitet, nuk ka fshat në Komunën e Obiliqit që nuk është e shtruar. Singerisht të gjithë indikatorët nuk i bëjmë ne dhe nëse, e keni dëgjuar z.Berat, me vëmendje ai ishte mjaft i qartë. Do të thotë, nuk kemi mund me shtue diçka e cila nuk është e përcaktuar në bazë të indikatorëve të cilët nuk i kemi përcaktue ne. Këto, vlejne për të gjitha Komunat, por ajo që është kërkuar nga ne e kemi plotësuar dhe jemi të radhitur si Komunë, ku edhe jemi.

Ajet Berisha – Nuk është që po ankohe se Komuna e Obiliqit, ka përparue shumë në ndërtim të infrastrukturës dhe shumë elementeve tjera, kjo është botërisht e ditur sepse fatbardhësisht po kemi mjete. Qëllimi im është me ditë këta indikatorë kur janë ardhë qind për qind çka është marrë për bazë dhe unë e respektoj shumë këtë çka e tha z.Berat. Do të thotë praktikisht për ato çka mirëmbahen kishte thënë qind për qind, por jo për pjesët tjera. Unë nuk e kam për qëllim këtë me zënë ngushtë, unë e kam për qëllim me kuptue çka ka dashtë me thënë. Tash, është e qartë se indikatorët nuk është aq që shikohen me llupë dhe kjo po kuptohet, por me rëndësi është se kjo nuk i ndodhë vetëm Komunës së Obiliqit. Kjo, i ndodhë krejtë Komunave me këto kushte Komuna e Obiliqit është radhitë e 4-ta, apo e 5-ta, që është sukses, urime.

Ibush Mjekiqi – U përmendën se janë 4 faktorët kryesorë që përfshihen në performancë dhe janë edhe tjerët. Te 4 faktorët kryesorë ne s'kemi mund me mbërrit qind për qindëshin për shembull është raporti i auditimit i pakualifikuar që është bazë një prej 4 faktorëve. Pastaj, janë investimet kapitale mbi 75 %, do të thotë duhet me mbërrit 75 %-in, me u futë në këtë garë dhe janë disa indikatorë tjerë. Pra, qind për qindshi është në bazë të kërkesave, e jo në bazë të asaj që u kuptuam.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për dhënien e pëlqimit për diskutim publik të Kodit etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që Kodi etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit të jepet në diskutim publik dhe pasi të kthehet nga diskutimi publik do ta japim kontributin tonë si anëtarë të Kuvendit.

Sami Ahmeti – Kodi etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit qoftë për ata publik, qoftë për ata politikë është është shumë i rëndësishëm. Më pëlqyen disa nene të këtij kodi për shembull kodi i veshjes, kodi moral, punësimet, keqpërdorimet, e posaqërisht neni 5 që fliste për respektimin e vullnetit zgjedhor të

qytetarëve, apo qysh zyrtari politikë duhet me shmangë ndërrimin e partisë gjatë ushtrimit të mandatit. Bashkë për asgjë, as për punësim të djalit, as për lejim të ndërtimit të shtëpive në zonën e interesit, as për me marrë ndonjë banesë për shokë e jarana, shumë më pëlqeu. Andaj, si grup i anëtarëve të Kuvendit jemi pro që ky kod të delë në debat publik.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien e pëlqimit për diskutim publik të Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e kërkesës nr.-III-392, të dt.16.12.2022, për aprovimin e Planit Komunal të Integritetit për vitin 2023-2026.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që të aprovohet plani i integritetit.

Sami Ahmeti – Plani komunal i integritetit është një dokument i rëndësishëm dhe ne si anëtarë të LVV-së, do të votojmë pro tij. Ne pajtohemi plotësisht me paragrafin e fundit të deklaratës të integritetit ku thotë:” Ne besojmë që ky plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën kundër korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe të respektimit të Kodit etik, në mënyrë që qytetarëve të iu kthehet besimi në Komunën e Obiliqit”. Nga ky paragraf kuptojmë se në Komunën e Obiliqit, ka korrupsion dhe ky plan i integritetit do të ndihmoj në luftën kundër tij. Pastaj, mungon kultura organizative e punës dhe respektimi i Kodit etik, që prapë ky plan do të ndihmoj në mënyrë që qytetarëve të iu kthehet besimi i humbur në Komunën e Obiliqit. Prandaj, e ritheksoj jemi pro këtij plani.

Ajet Berisha – Mendoj se të gjitha këto që i parashehë ky projekt plan komunal është e mbuluar krejtësisht me ligjet e Republikës së Kosovës. Me vetë faktin se bartës kryesor për realizimin e këtij projekt plani është Kryetari i Komunës, unë nuk po di qysh duhet me ndërtue dhe me besue që ka me ndryshue diçka me këtë plan kur për të gjitha këto deri tash Kryetari i Komunës, veç ka pasë përgjegjësi. Për me u realizue diçka e tillë kishte me qenë mirë mos me qenë bartës Kryetari i Komunës dhe funksionimi i institucioneve demokratike është kontrolli. Me vetë faktin që prapë Kryetari i Komunës e ka rolin kryesor për këtë, dua ta tregoj një tregim se nuk di qysh me ilustrue më mirë. Arën me rrush e ruajnë baba dhe djali dhe vjen baba në shtëpi në ora 12 e dërgon djalin, por pas gjysmë ore djali kthehet në shtëpi, e baba e pyet pse u ktheve e nuk po e ruan rrushin. Djali i thotë jo se kojshia Xhaferi, ishte aty dhe mbeti me rue ai dhe baba i thotë jo djali im mos me qenë Xhaferi, ne nuk do ta kishim ruajtë rrushin hiç. Edhe këtu, mendoj se përgjegjësi kryesor për zbatim të ligjeve është z.Xhafer Gashi, andaj nëse ai është bartës për me realizue këtë, unë dyshoj se ka me pasë ndonjë efekt ky dokument i miratuar nga ne.

Ibush Mjekiqi – Ju lus, të jeni më të matur në fjali dhe në fjalor sepse nuk është fjalor që i përket Kuvendit, nuk është e nivelit të anëtarëve të Kuvendit edhe z.Ahmeti dhe z.Ajeti, ju kisha lutë ne nuk po atakojmë, as nuk po përdori personalisht fjalë të rënda. Prandaj, ju lutem përmbanu sepse nuk është në rregullë dhe ky shtet në të cilin jemi a është i brishtë, a është i fortë, apo nuk është i fortë, a kemi besim apo nuk kemi besim z.Ahmeti, është dikush tjetër që na jepë besimin. Ju lutem, janë masat me të cilat e matim besimin, prandaj kisha me kërkue nga ana juaj të jeni më të kujdesshëm sepse jeni në nivel tjetër. Me respektin më të madh për të gjithë njësoj kisha pasë dëshirë që të kenë një kulturë të komunikimit pa fjalë bombastike.

Kryesuesja – Ju falenderoj shumë për të gjitha diskutimet dhe debatet që po i bëni. Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për dhe 1 votë abstenim e aprovuan Vendimin për Planin e integritetit për vitin 2023-2026.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e raportit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale sipas rekomandimeve të Ministrive të linjave. Ju, e keni pranuar një raport nga Komisioni i cili e ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e kësaj Rregulloreje, në bazë të rekomandimeve të Ministrive të linjave.

Enver Gashi – Ne veç një herë e kemi pasë këtë pikë të rendit të ditës dhe Rregullorja në fjalë ka shkue në Ministri të pushtetit lokal, vërejtjet janë dhënë dhe besoj se ky Komision e ka krye punën e vetë si duhet. Ne jemi për aprovimin e Rregullores dhe ta kryejmë një herë e përgjithmonë këtë çështje.

Sami Ahmeti – E thamë edhe në mbledhjen e KPF-së, që ky raport është kërkesë për me i bë ndryshimet në Rregulloren që ne e kemi miratue, apo disa asambleistë e kanë miratue në seancën e muajit tetor. Do të thotë, këto janë vërejtjet që i kanë kthye Ministrinë gjegjëse për gjërat që mungojnë, e disa që janë të tepërta dhe është normale që kjo Rregullore të rivotohet, në mënyrë që të bëhet e plotëfuqishme. Atëherë, kemi qenë kundër kësaj se kemi pasë vërejtje, edhe sot jemi kundër, por kjo nuk do të thotë se kjo nuk duhet të ndryshohet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për, 3 vota kundër dhe 1 votë abstenim e aprovuan Vendimin për plotësim ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale sipas rekomandimeve të Ministrive të linjave.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Kemi një kërkesë urgjente nga Drejtoria e Arsimit, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorit në SHFMU “Naim Frashëri” në Breznicë sipas konkursit të publikuar. Në Komision sipas Udhëzimit Administrativ propozohet të jetë: 1.Fatime Pllana, shefe e sektorit të Arsimit në Drejtorinë e Arsimit, Kryetare e Komisionit, 2.Bashkim Ismaili, drejtor në SHFMU “Migjeni” në Sibofc, anëtar dhe përfaqësuesi i tretë është nga Ministria e Arsimit.

Enver Gashi – Kjo është një procedurë që ka ardhë nga Ministria dhe ne këtu, nuk jemi që mundemi me i ndryshue as ligjet, as Udhëzimet administrative, kështu që jemi për që të kaloj kjo kërkesë.

Sami Ahmeti – Për me miratue gjithsesi se jemi sepse jemi për me u plotësue ai vend nëse, veç është bosh. Për çështjen që është urgjente, po më çuditë pse është urgjente, pse nuk ka ardhë me kohë dhe pse ne nuk kemi pasë mundësi me trajtue. Për diçka që bisedohet në Kuvend, duhet paraprakisht me pasë dokumentin me ditë kur ka ardhë kjo që është urgjente, e sigurisht jo sot dhe ka pasë mundësi me na u dërgue edhe neve, për hir të asaj që të jemi të përgatitur dhe ta japim kontributin tonë. Si kështu bosh, ne nuk kemi ndonjë koment.

Ajet Berisha – Jo, unë s’po e kuptoj paskan ndërrue Udhëzimet Administrative, sepse Kuvendi, këto nuk i ka votue dhe për këtë u befasova dhe nuk disha se çka po kërkoni.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 5 vota abstenime aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorit në SHFMU “Naim Frashëri” në Breznicë sipas konkursit të publikuar. Në Komision sipas Udhëzimit Administrativ propozohet të jetë: 1.Fatime Pllana, shefe e sektorit të Arsimit në Drejtorinë e Arsimit, Kryetare e Komisionit, 2.Bashkim Ismaili, drejtor në SHFMU “Migjeni” në Sibofc, anëtar dhe përfaqësuesi i tretë është nga Ministria e Arsimit.

Kryesuesja – Ne e kemi cekë edhe në mbledhjen e KPF-së, ku pas propozimit të z.Enver Gashi, duhet të merret një vendim për furnizimin e anëtarëve të Kuvendit me llap topë.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Sami Ahmeti – Pasi që ka të bëjë me rritjen e performancës të anëtarëve të Kuvendit komunal me shpresë se vërtetë, do të rritet performanca e tyre, ne jemi pro kësaj kërkesë që të blehen llap topët e rinjë për të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për e aprovuan Vendimin për furnizimin e 21 anëtarëve të Kuvendit komunal me llap topë.

Kryesuesja - Është një kërkesë që ka ardhë nga MAPL-ja, lidhur me vendimin nr.160, të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit nr.-I-145, i dt.26.10.2022, i Komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave lokale me anëtarin z.Bajram Hashani nga LDK-ja, në vend të z.Sami Ahmeti nga LVV-ja. Sipas Ministrisë propozimi nga kërkuesja fillimisht duhet të kërkohet nga subjekti politik i cili ka dhënë dorëheqje në Komisionin e ankesave, pastaj nëse, subjekti politik nuk ka propozim për zëvendësim kalohet në subjektin tjetër të radhës. Pra, kërkohet që votimi të përsëritet në pajtim me rregullat e parapara. Andaj, i nderuari z.Sami Ahmeti, shef i grupit ju lutem të propozoni një anëtar i cili do të jetë përfaqësues, ose anëtar në Komisionin e ankesave në procesin e zgjedhjes së Këshillave lokale të fshatrave.

Sami Ahmeti – E nderuara, kryesuese e Kuvendit komunal, duke pasë parasysh se ne kemi pasë vërejtjet tona dhe kemi një kthim të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë se procedurat e zgjedhjes së Komisioneve, të

Këshillave të fshatrave nuk kanë shkue ashtu siç duhet, ne nuk kemi emër dhe nuk do të propozojmë sepse konsiderojmë se ky Komision, është veç sa për me thënë se është sepse nuk do të ketë punë se ato Këshilla të fshatrave tashmë janë zgjedhë para 2 muajve. Ne nuk ua prishim, vazhdoni me emra qysh keni qenë apo propozojmë këdo tjetër, si LVV nuk kemi propozim.

Kryesuesja – I nderuari, z.Sami Ahmeti edhe pse jeni kundër këtij Komisioni, ju nuk keni asnjë propozim për këtë Komision.

Sami Ahmeti – Nëse, doni e ripërsërisë përsëri, do të thotë nuk kemi, jemi kundër kësaj forme qysh ka shkue dhe pasi që të shpallen ne i kemi procedurat tona, përsëri do të kërkojmë ligjshmëri nga MAPL-ja. Mirëpo, lidhur me Komisionin për ankesa si grup i LVV-së, nuk kemi propozim andaj lirisht mundeni me vazhdue.

Kryesuesja – Meqenëse, nuk ka qenë në procesverbal, Ministria ka kërkuar që të shkojmë prapë në këtë formë dhe nuk është aspak telashe. Atëherë, pas LVV-së vjen LDK-ja, dhe a jeni prapë, apo propozoni dikend tjetër.

Bajram Hashani – Qëndrojmë prapa atij propozimi dhe nuk kemi tjetër.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 4 vota abstenim e aprovuan Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.-I-145, i dt.26.10.2022, i Komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave lokale me anëtarin z.Bajram Hashani nga LDK-ja, në vend të z.Sami Ahmeti nga LVV-ja.

Kryesuesja - Të nderuar, anëtarë të Kuvendit e kemi potencuar edhe në KPF, që të formohet grupi punues për hartimin e planit të punës të Kuvendit komunal për vitin 2023, nëse jeni dakord të shkojmë me 3 anëtarë siç kanë qenë.

Enver Gashi – Është mirë të hudhet në votim përbërja e Komisionit prej 3 anëtarëve.

Kryesuesja – E hudhi në votim përbërjen e Komisionit prej 3 anëtarëve.

Aëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 4 vota abstenim votuan që përbërja e Komisionit të jetë prej 3 anëtarëve.

Enver Gashi – Propozoj z.Jeton Mjekiqi, për anëtar të Komisionit.

Sami Ahmeti – E propozoj veten.

Bajram Hashani – Gjithashtu, edhe unë e propozoj z.Bajram Hashani.

Pas propozimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për e aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e planit të punës të Kuvendit komunal për vitin 2023 me këtë përbërje: Jeton Mjekiqi, Sami Ahmeti dhe Bajram Hashani.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesja – Në mbledhjen e KPF-së, z.Sami Ahmeti i ka paraqitë 3 kërkesa, apo 3 pyetje. Njëra, ka qenë sa i përket auditorit të brendshëm për të cilin ka kërkuar të raportoj për këtë vit, nga drejtori i bujqësisë dhe ka qenë lidhur me 2 kontrata të njejta të shpallura në prokurim të drejtorit z.Fatmir Bërbatovci. I nderuari z.Ahmeti po ju lexoj përgjegjen nga Besnik Rama, auditor i brendshëm, i cili thotë se njësia e auditimit të brendshëm në Komunën e Obiliqit, funksionin e saj e zbaton si njësi e pavarur dhe sipas nenit 21, paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-021, për kontrollin e brendshëm të financave publike, njësia e auditimit të brendshëm ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtëpërdrejtë vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik dhe njofton Komitetin e auditimit, respekton dispozitat ligjore dhe punën e saj e zbaton konform tyre.

Ajet Berisha – Sa i përket performancës, e keni marrë 0 përqindje për këtë arsye se auditori i brendshëm nuk dërgon raport në Kuvend dhe qysh ka mundësi ky me u thirrë në atë nen sepse tash, nuk është që unë po i njohë ligjet krejtë. Mirëpo, merrne raportin e performancës dhe shihni, e keni përqindjen 0 pikërisht për mungesë të raportimit të auditorit të brendshëm, ose le të harmonizohen ligjet, ose Besniku, ku e ka marrë këtë. Këtë e ka bërë Qeveria, për krejtë Komunat, indikatorët janë për krejtë Komunat dhe thotë auditori i brendshëm nuk ka bërë raport për Kuvendin, e kemi 0 përqindje.

Sami Ahmeti – Ishte pikërisht LVL-ja, ai i cili më ka shtye me bë këtë kërkesë sepse neni 52 i këtij ligji thotë që auditori, që nuk do të thotë se ai me ardhë drejtëpërsëdrejti se ai mundet edhe kështu pyetja ka qenë Ekzekutivi, apo vetë auditori. Auditori i raporton dikujt në Ekzekutiv, e dikush prej Ekzekutivit na raporton neve, sepse e ka obligim jo vetëm raportin, por e ka obligim edhe planin vjetor të auditimit të ia sjellë Kuvendit, respektivisht bile KPF-së, gjithsesi. Kjo, është arsyeja pse ne kemi bërë kërkesë, jo me i ndërhy atij në punë sepse të kuptohemi edhe pse është zyrtar publik, edhe pse është zyrtar brenda një zyre të Komunës, ai nuk është privat dhe nuk e përfaqëson shtëpinë e vet. Ai e përfaqëson institucionin dhe ne jemi përfaqësues politikë që kërkojmë informata. Kjo, më duket se është përgjegje shumë e thatë megjithatë, ne do të bëjmë kërkesë edhe me shkrim në mënyrë që ai të përgjegjet dhe të shohim se çfarë ka.

Ibush Mjekiqi – Pikërisht, te përgjegjia dua të them se pavarësisht se në çka është thirrë ai, ne do ta analizojmë këtë çështje bashkë me Kryetarin dhe nëse, duhet e po supozojmë se duhet me qenë raporti i auditorit, atëherë ka me qenë dhe cilitdo të ndonjë zyrtari tjetër, e jo vetëm i auditorit. Hera e parë është që po e dëgjoj këtë dhe nëse, është ligjore, nëse është obligative ka me qenë në Kuvend, pavarësisht përgjegjeve. Nuk është me rëndësi emri i kujt është, por i rëndësishëm është institucioni, apo zyra të cilën ai e përfaqëson.

Kryesuesja – Sa i përket pyetjes së drejtorit të bujqësisë, ai atë ditë në KPF ishte i gatshëm të përgjegjet, por ju kërkuat në Kuvend. Drejtori e ka dërgue me shkrim për shkak se ka udhëtue jashtë vendit dhe unë do të ua dërgoj kopjen fizike, ose në email. Përgjegjia e drejtorit z.Bejtullah Mjekiqi, është se gjatë vitit 2021 kemi pasë disa kërkesa për dëmet nga fatkeqësitë natyrore dhe nga faktori njeri, 4 kërkesa në shpeztari, dëmet të pulat, patat dhe në zogjë. Këto dëme, Ministria e bujqësisë, nuk i kompenzon. Një kërkesë për dëm në bletari s'ka qenë nga fatkeqësitë natyrore. Dëmet nga breshëri me dt.05.06.2022, në fshatin Hade, Lajthishtë dhe Shipitullë, kemi pasë 8 kërkesa të cilat janë përcjellë në Ministri të bujqësisë nga Komisioni. Janë përkrahë 2 kërkesa ndërsa, 6 janë refuzue, nuk i kanë plotësue kriteret për kompensim, 4 kërkesa për vjedhje të lopëve. Ministria e bujqësisë nuk i kompenzon vjedhjet. Për dëmet nga zjarri janë 4 kërkesa dhe Ministria e bujqësisë i kompenzon vetëm ato që janë nga vetëtimat, apo nga reja, kështu që janë të refuzuara. Për dëmet nga breshëri 28 kërkesa me dt.28.09.2022, Komisioni me dt.12.10.2022, ka dalë në terren dhe ka bërë vlerësimin 26 kërkesa janë refuzuar sepse dëmet kanë qenë shumë të vogla dhe nuk kanë qenë për vlerësimin. Po ashtu, 2 kërkesa për dëmet në serë, folitë e dëmtuara nga era dhe një dëm në mjedrta janë përcjellë në Ministri të bujqësisë dhe janë përkrahë. Këto, i ka verifikue edhe Komisioni i Ministrisë së bujqësisë. Ne 3 kërkesa për dëmet nga vërshimet e fundit i kemi dërgue në Ministri të bujqësisë dhe nuk i kanë pranue. Janë 58 kërkesa të pranuar, 12 të përcjellura në Ministri të bujqësisë, 4 janë kompensue, 8 janë refuzue për shkak të kriterëve, 3 nuk janë pranuar në Ministri të bujqësisë.

Sami Ahmeti – E falenderoj drejtorin edhe pse nuk është këtu, për përgjegjen aq sa e ka kuptue të saktë. Kjo është pjesa e dytë e pyetjes time që e kam bërë sepse pyetja e parë ka qenë a është e vërtetë që në Komunë nuk janë lejuar disa fermerë me aplikue për dëme. Ne kemi informata se qytetarë të caktuar nuk janë lejuar me aplikue fare duke thënë se nuk kemi buxhet. Kjo, ka qenë pyetja kryesore ndërsa, pyetja e dytë ka qenë a keni lista të atyre që kanë aplikue. Unë gjithsesi e falenderoj drejtorin për përgjegje ndërsa, për pjesën tjetër besoj se do të ju dërgoj një kërkesë me shkrim në drejtim të Drejtorisë. Në web faqen e Komunës së Obiliqit, janë shpallë 2 kontrata të njejta të bashkëfinancimit me MAPL-në, për projektin e rehabilitimit të infrastrukturës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Plemetin, njëra mban datën 09.09.2022 dhe tjetra mban datën 25.11.2022, të dyja për projektin e njejtë. Njëra ka kohëzgjatje 75 ditë, ndërsa tjetra e ka kohëzgjatjen një vit, por edhe çmimin përafërsisht e kanë të njejtë. Tani, ne kërkojmë nga Drejtoria përgjegjëse që në séance e radhës, që e kemi thënë në KPF, që në këtë seancë të na përgjegjet se a është shkëputur zyrtarisht kontrata e parë pasi që kemi 2 muaj më vonë një kontratë të njejtë, a ka kryer operatori ekonomik ndonjë situacion të kësaj kontrate, a është bërë ndonjë pagesë për kontratën e parë dhe si është e mundur që të 2 kontratat të fitohen nga një operatorë.

Ibush Mjekiqi – Është e vërtetë se kanë qenë 2 kontrata, por është drejtori i cili më detalisht do të përgjegjet.

Fatmir Bërbatovci – Përgjegjet lidhur me pyetjen e ngritur të shefit të grupit parlamentar të LVV-së, Drejtoria dhe unë si drejtor i infrastrukturës, e kam përgatitë një raport në bazë të gjendjes, respektivisht në bazë të kronologjisë së thjeshtë se si është zhvilluar ky projekt. E tha edhe anëtari i Kuvendit i nderuar me punime në realizimin e projektit bashkëfinansim rehabilitimi i infrastrukturës fizike të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian kemi filluar në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar nga ministri i MAPL-së dhe Kryetarit të Komunës. Punimet kanë filluar me datën 13.09.2022, me planin dinamik siç e thatë edhe ju 75 ditë. Pasi kanë filluar punimet kemi marrë një njoftim nga MAPL-ja, si monitoruese e këtij projekti se në kontratë janë evidentuar disa gabime, do të thotë 2 gabime arithmetikore dhe shkalla e gabimeve kalon mbi 2 %, që në këto raste kontrata duhet të ndërprehet. Ne e kemi njoftuar operatorin ekonomik me dt.27.09, pasi kemi marrë njoftimin nga zyra e prokurimit dhe monitoruesit e MAPL-së, se duhet të ndërprehen të gjitha punimet dhe të mos hapen pozicione të reja. Me dt.21.10, është formuar Komisioni prej 3 anëtarëve i cili ka bërë ndërprerjen e punimeve, respektivisht vlerësimin e punëve të kryera në këtë kontratë. Vlerësimi i Komisionit ka qenë se punimet në këtë projekt janë realizuar gjithsej 104,359 euro nga totali prej 249,168 euro. Në konsultim me Ministrinë, pasi që ata na kanë njoftuar se zotimi prej 100,000 euro nga ana e Ministrisë mbetet aktiv ne e kemi ritenderuar këtë projekt me dt.27.10.2022. Në ofertën e rishpallur kanë ofertuar 3 operatorë ekonomikë dhe ofertat i ka vlerësue Komisioni prej 3 anëtarëve. Kontrata e ritenderuar për projektin bashkëfinansim rehabilitimitin e infrastructures është bërë me dt.25.11, punimet kanë filluar me dt.26.11.2022, dhe janë punuar punë deri tash në vlerën prej 100,000 euro, do të thotë aq sa ka qenë edhe zotimi i MAPL-së.

Sami Ahmeti – E thatë se 104,000 euro, e ka vlerësue Komisioni që është bërë punë dhe pyetja ka qenë a janë paguar ato 104,000 euro, apo nuk janë paguar. Atëherë, pse kontrata e dytë ka përsëri çmimin e njejtë me një ndryshim vetëm 5,000 euro, e jo 100,000 euro, kur bëhet fjalë për kontratën e njejtë.

Fatmir Bërbatovci – Arsyeja është se edhe kontrata është një vjeçare sepse janë shtue edhe disa pozicione të cilat edhe nuk kanë qenë. E kemi vërejtur gjatë realizimit të punimeve se ka nevojë për disa pozicione shtesë psh janë harrue disa objekte ndihmëse dhe këto i kemi futë disa pozicione tjera të cilat janë të paraqitura në kontratë. Kontrata është një vjeçare sepse nuk ka mund me u realizue për vitin 2022.

Sami Ahmeti – A ka mundësi drejtori këtë raport që e ka përgatitë pa bërë fare kërkesë me na dërgue, apo duhet me bë kërkesë me shkrim përsëri.

Kryesuesja – Tani, i drejtohem zyrtarit për qasje në dokumente zyrtare, a ka nevojë z.Sami Ahmeti, me i bë kërkesë drejtorit të bujqësisë për me pasë këtë raport, apo formalisht mund të dorëzohet raporti.

Adem Haliti – Z.Sami, ne këtë vit që po e mbyllim gati 20 dokumente qasje ke bë dhe kemi kalue mirë, korrekt dhe sipas ligjit i kam kthye të gjitha. Unë me vendim të Kryetarit si përgjegjës për qasje në dokumenjte publike, por së pari kërkesa bëhet në sportel, atë kërkesë unë e pranoj dhe e dërgoj për shqyrtim te Drejtoria përkatëse dhe ligji për qasjen në dokumente publike pas 7 dite, ti jepë edhe 7 tjera, varet prej vëllimit të punës apo edhe prej kërkesave që i ke kërkuë dokumentet. Prandaj, kërkesa që bëhet gojarisht këtu, kthehet edhe përgjegjja gojarisht ndërsa kërkesat që unë i pranoj dhe tash e mbylli vitin që i jepi raport Kryetarit të Komunës dhe Agjensionit për mbrojtje dhe privatësi të dhënave personale, do të thotë vijnë përmes meje që jam përgjegjës.

Sami Ahmeti – Z.Adem je njësh.

Shaip Paloja – Shfrytëzoj rastin të ju uroj juve dhe qytetarëve të Obiliqit, festat e fundvitit. Ky Kuvend, fatkeqësisht i jepë mundësi gjithkujt edhe me ofendue dhe me paraqitë gjëra jo të vërteta, por sido që të jetë këtu jemi anëtarë të Kuvendit, që mendoj se jemi shumë të përmbajtur. Dikush është munduar 3,4 subjekte i ka ndërrue derisa ka ardhë në këtë Kuvend, fatkeqësisht sot iu ka dhënë mundësia me mbajtë fjalë dhe me i shitë dikujt moral dhe etikë, që është fatkeqësi e madhe kjo. Unë kam një pyetje për kolegët e vetëvendosjes dhe unë e di se këta nuk janë përgjegjës, por besoj se duhet me na dhënë një përgjegje se ndoshta kanë komunikue me anëtarët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në seancën e fundit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë propozue 6 amandamente për Obiliqin dhe fatkeqësisht anëtari që vjen nga Obiliqi dhe komplet vetëvendosja votojnë kundër ndërsa, plot gojën e kanë interes të qytetarit të Obiliqit.

Këta, nga të sillen e dojnë veç Obiliqin dhe qytetarin, bile iu kisha lutë për me dashtë shumë aman mos u mundoni shumë për Obiliqin se Obiliqi, po ecë përpara me të madhe. Ndërtimi i kopshtit në Milloshevë, rr.Obiliq-Milloshevë, kogjenerimi 2 milionë është kërkuar një amandament nuk ka kaluar, nuk e ka votuar vetëvendosja, drunjët dekorativ, ura në Graboc, rruga Obiliq-Fushë Kosovë, ju kisha lutë si kolegë, e di që këta nuk e kanë atë përgjegjësi, por a kanë komunikuar me ata njerëz pse këto nuk kanë kaluar, kur është fjala edhe këta vetë deklarohen se e dojnë Obiliqin, e dojnë qytetarin e Obiliqit, pse nuk kanë kaluar këto amandamente.

Sami Ahmeti – Faleminderit shumë edhe prej personit që e bëri pyetjen. Sa i përket pjesës hyrëse kush ka ndërruar, çka ka ndërruar ajo më dihet dhe s'kemi nevojë me biseduar.

Shaip Paloja – Unë kërkoj falje, është mandati im i tretë dhe asnjëherë në këtë formë nuk kam reaguar, por më nxiti më heret një fjali.

Sami Ahmeti – Unë nuk e di pse po e merrë aq personale, apo e ke mizën pas veshit se ka edhe tjerë këtu, që kanë bërë ndryshime. Nëse, e ke marrë personale, kërkoj falje. Sido që të jetë për pyetjen konkrete në seancën e muajit shtator ka qenë të paktën njëra prej këtyre pikave, që është ngritë që ne si grup parlamentar i LVV-së, këtu kemi kërkuar nga ky Kuvend, që me përfshi në planifikim buxhetor çerdhen në Milloshevë dhe 4 propozime tjera. Ky Kuvend, ju që po shiteni, ju keni qenë kundër, nuk keni pranuar që ajo pikë të hyjë në propozim. Bashkë me z.Halil, menjëherë si ka filluar me u biseduar çështja e buxhetit qëndror, ne i kemi shkruar drejtoreshës së financave dhe i kemi thënë se a keni nevojë me mbështet ndonjë projekt. Përgjegjja me sms prej drejtoreshës është se nuk kemi asnjë projekt vetëm mundësisht mos na i hiqni projektet që i kemi miratuar. Të kuptohemi se ne jemi për të mirën qytetare, por kur ju vetë i keni kundërshtuar projektet dhe tash po provoni me nxjerrë që subjektet tjera, me ju mbështetë ne të paktën i shkojmë përpara planit të Qeverisë, e jo planit të disa personave. Ne e kemi krye hakun në drejtim me juve. Ne kemi kërkuar në kohën kur kemi mund me futë atë amandament, në ndërkohë që ju në fund shpik me i shti do të thotë nuk ka pasë mundësi sepse 1.nuk ka pasë projekte, 2. Ne shpesh e përmendim çerdhen në Milloshevë, por s'ka prona ku të ndërtohet ajo dhe disa herë është rialokuar për shkak të mospronës. Do të thotë me u krijue zëra buxhetor edhe në buxhetin e shtetit nuk mund të krijohen kështu pa projekte sepse vetë nuk i keni kushtuar rëndësi kur ka qenë debati dhe kur ka qenë mundësia me i shti në buxhet. Atëherë, ka qenë shumë më lehtë me i përkrahë, ose me i shtye përpara. E ritheksoj jemi për të mirën e qytetarëve, mirëpo agjendat e kërkujt nuk i shtyejmë përpara. Ne i shtyejmë përpara agjendat e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Enver Gashi – Ne sot e patëm një Kuvend më duket jashtë etikave që e kemi pasë gjithë se po e përmbysim një vit. Ndoshta, ka qenë edhe koha e fundit e me u zbrazë pak, por unë ju kisha dëshiruar një vit të ardhshëm më të mirë se ky vit. Ju kisha falenderuar të gjithëve për punën që e kemi bërë në këtë vit me shpresë se viti tjetër do të na gjejë edhe më të bashkuar.Sa i përket projekteve, a i shtyejnë të Qeverisë ne jemi të thirrur dhe votën e kemi vetëm për Komunën e Obiliqit. Urime dhe suksese.

Labinot Mirena – Unë deshta të ndërlidhem te parafolësit e mi z.Paloja dhe z.Ahmeti. Rruga Dardhishtë – Fushë Kosovë, nuk është e Kryetarit të Komunës, por e banorëve që i lidhë 2 Komunat, do të thotë Fushë Kosovën dhe Obiliqin. Nuk është dashur me i heqë se e keni parë para disa dite një postim që e kanë bërë disa qytetarë të Dardhishtës, që ka qenë për të njejtën rrugë, edhe ju keni reaguar si me lot krokodielli, do të thotë e keni pasë të padrejtë. Unë kisha dashtë të ndërlidhem pak te çështja e punësimit, jo e kanë punësuar këtë e atë, vetëm gjema që dikujt iu ka mohuar me aplikuar për punë nëse, punon dikush familjar i tij. Nëse, i pamundësohet kjo, atëherë janë Gjykatat dhe lëndën mundesh me dërguar në Gjykatë sepse për me kritikuar dikend duhet vetë me qenë shembull e shembulli nuk je ti. Në konkursin e fundit të KEK-ut që është në Gjykatë, unë e di personalisht se ti e ke vllaun në atë listë, kështu që ti për me kritikuar dikend për punësime nuk ke të drejtë.Unë ti përmendi edhe aktivistët tjerë, se nuk dua me ra në atë nivel, por pasi tip o folë për punësime është mirë mos me folë sepse unë personalisht e njohë vllaun tënd para se me të njoftë ty dhe e vlerësoj shumë. Nuk është mirë ti me folë për të tjerët sepse folin njerëzit edhe për ty. Ju këndeje jeni për me punësu, jo pse po i punësojnë këta, edhe ju jeni duke i punësuar tuajt.

Sami Ahmeti – Faleminderit z.Labinot, për komentet dhe ato që i ngrite. Sa i përket rrugës, pasi që paska qenë aq e rëndësishme pse nuk e keni futë në buxhet, pse pasi që është krye puna po insistoni, pse, kjo është çështja. Te punësimi, unë nuk e di ku thashë, ose ku kam shkruar, gjeje një shkrim timin që e kam thënë, do të thotë e ke gabim, ia huqe shumë sepse nuk përmenda hiç. Sa i përket asaj nëse dojmë të flasim për punësim, unë asnjë familjarë nuk e kam në KEK. Unë nuk punoj në KEK. Ne jemi kundër nepotizmit, kur ti punon në të njejtin institucion dhe në kompaninë e atij institucioni dhe i futë anëtarët e familjes tënde, kjo është për me kritiku, por kurrë nuk e kam kritikue. Mirëpo, gjeje lirisht unë jam në gjendje me tu përgjegjë. Kritika të tilla nuk kam bërë sepse pikërisht për punësimet e qytetarëve pa marrë parasysh çfarë partie është jam në gjendje gjithçka me bërë. Këto prona që po jepen janë pikërisht për me ngritë numrin e punëtorëve sepse tek atëherë, bëhet përmirësimi i gjendjes dhe mirëqenies së qytetarëve.

Labinot Mirena – Te punësimi, e përmende jo me shti djalin, jo me i dhënë banesë familjare që u përfolën emrat e kolegëve, që unë aludoj në ata dhe ti ke aludu bash në ata që i ke përmendë. Te çështja e familjarëve me iu dhënë banesa, unë nuk po besoj psh se është ashtu siç po thua ti se edhe nëse, është ashtu qysh po thua ti ata njerëz është dashur me u përballë me drejtësinë. Unë kisha kërkue bash prej atij personi që e ke apostrofue disa herë me ngritë padi edhe personale ndaj teje sepse nuk është e vërtetë ajo që e thua. Unë për rr.Dardhishtë-Obiliq-Fushë Kosovë, për investime kapitale Komuna e Obiliqit, është një ndër Komunat që shpenzimet kapitale i ka bërë mbi 90 % dhe nuk ka mund shumë projekte me i kaluar për shkak se i ka kaluar ato tjerat, që kanë qenë të nevojshme. Po ashtu, duke e pasë atje në Parlament tonin, një njeri që është prej Obiliqit, është dashur të paktën me kërkue me reague për të mirën e Obiliqit, se tek e fundit edhe unë kam familjarë, kanë edhe tjerët, prandaj është dashur me përkrahë.

Kryesuesja e Kuvendit komunal e lëshoi mbledhjen për shkaqe shëndetësore dhe u zëvendësua nga anëtari më i vjetër z.Enver Gashi, i cili vazhdoi me udhëheqjen e mbledhjes.

Albanë Shillova Shalaku – Unë kam një pyetje për drejtuesit e Arsimit, a e dini se vendosja e kamerave në sallat e arsimtarëve është e ndaluar me ligj. Ato lejohen të vendosen koridoreve në pjesët e jashtme të objektit, por jo edhe në salla sepse e çenojnë privatësinë e mësimit dhe nxënësve. Kjo, ka ndodhë në disa shkolla të Komunës së Obiliqit dhe ne kërkujmë që ato të hiqen, në të kundërtën do ta njoftojmë, apo informojmë inspektoriatin e Arsimit.

Enver Gashi – Këtë kërkesë do ta adresojmë te drejtori i Arsimit.

Ajshe Haliti Pllana – Unë kam një kërkesë për drejtoreshën e administratës që përmes IT-së kisha kërkue që në web faqen ku i kemi ne emrat si asambleistë të vendosen edhe së paku emailat tona zyrtare, pasi që kam pasë edhe kritika ndoshta, se nuk po mundem me na gjetë organizatat, ose individët e ndryshëm. Kjo, besoj se askujt prej kolegëve nuk i prish punë.

Lindita Bektashi – Kjo punë është teknike dhe ne mund ta kryejmë gjatë ditës, ose nesër.

Valon Svirca – Në shkollën e Milloshevës, në muajin e fundit ka qenë e angazhuar një mësimitdhënëse e artit figurativ. Asaj, të martën iu ka ndërprerë marrëdhënia e punës me kërkesën e Kryetarit të Komunës, sepse i njejtin donte ta dërgonte dikend tjetër aty. Këto, informata i kemi marrë prej nxënësve që i kanë dëgjuar prej mësimitdhënëseve dhe nëse, Nënkryetari mundet me na sqarue këtë çështje. Pasi që po bëhet fjalë për të njejtën shkollë një mësimitdhënëse e klasës së pestë që e keni sjellë nga Drenasi. Ajo kur ka kërkue nga nxënësit me bërë një vizatim çfarëdo qoftë të thjeshtë, nxënësit kur e kanë pyetur çka të vizatojnë ajo iu ka thënë vizatone Hashim Thaqin. Ne kemi edhe fakte për këtë çështje. Mendoj se as nuk ka nevojë me vizatue Hashim Thaqin, as Albinin, por ma merr mendja ndoshta është dashur me vizatue Adem Jasharin, ose Skënderbeun.

Fidan Ahmeti – Unë e kam një pyetje për DSHPE-në, a ka mundësi në sezonën jashtë verës, po mendoj në këtë sezonë që jemi mos me qenë e ndaluar qarkullimi i automjeteve nëpër shesh sepse kurrfarë kuptimi nuk ka. Pothuajse, në çdo vend është e ndaluar vetëm gjatë verës qarkullimi, por në këtë sezonë që jemi nëse, është e mundur me pasë qarkullim edhe pas orës 19.

Abdyrrahman Krasniqi – Realisht duhet me pa vendimin e Kuvendit qysh ka qenë më heret dhe nëse, kjo kërkesë është e arsyeshme ne do të veprojmë në bazë të kërkesave të qytetarëve.

Ibush Mjekiqi – Unë për këtë pyetje nuk kam përgjegje, ndërsa sa i përket pyetjes tjetër meqë, drejtori i Arsimit nuk është këtu, duhet me shkue në shkollë me shikue a janë vendosë kamerat, apo jo pastaj, me i marrë hapat e duhur. Në mbledhjen e ardhshme do ti keni përgjegjet për të dy pyetjet.

Valon Svirca – Te zyrtarja e prokurimit pyes pyes kush është Blerina Haziraj, e cila në dokumente duket se e ka zëvendësue Arta Alaj. Po ashtu, dua të di se kur është punësuar ajo, a ka pasë konkurs për punësim, në cilën platformë është shpallë konkursi, nëse kishe mund me na ndihmue.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet se është punëtore e OSHP-së, dhe e kemi kontraktue me kontratë që na lejon ligji, nuk është me konkurs. Për fund ju uroj vitin e ri, shëndet juve dhe familjeve tuaja.

Mbledhja përfundoi në ora 11:58'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi